РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr_____

_____г./v.

ДКСК KSHPK
ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА
KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e65-të, të mbajtur më 15.04.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-2616/1 i datës 06.08.2020, REFUZOHET.

KSHPK vërtetoi se lënda nuk ka elemente për veprimin e saj kompetent në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Lënda me numër 12-2616 të vitit 2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-2616/1 të datës 06.08.2020 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Në denoncim është paraqitur pakënaqësi me emërimin e një inspektori të punës ///, kundër punëdhënësit ///, për pagat e papaguara nga punësimi dhe regresin për leje vjetore. Nga KSHPK kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Nga mbikëqyrja e përmbajtjes së kërkesës, KSHPK-ja vërtetoi se rasti i caktuar ishte një mosmarrëveshje pune, për të cilën është kompetente ----------.

Sipas sa më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgaditi: Mr D. D.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar
Nuri Bajrami

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut
email: contact@dksk.org.mk
тел/tel: +389 2 3248 930
https://www.dksk.mk